



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministartstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademia za Javnu

Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

RREGULLORE (AKSP) NR. 02/2024 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

REGULATION (KAPS) NO. 02/2024 ON THE PREVENTION OF CONFLICT OF INTEREST IN THE KOSOVO ACADEMY FOR
PUBLIC SAFETY

UREDBA (KAPS) BR. 02/2024 O SPREČAVANJU SUKOBIA INTERESA U KOSOVSKOJ AKADEMIJI ZA JAVNU BEZBEDNOST

AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE Në mbështetje të nenit 14 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe nenit 20 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e FunkSIONIT Publik, Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike: Nxjerr: RREGULLORE NR. 02/2024 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE Neni 1 Qëllimi Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kriteret, rregullat dhe procedurat lidhur me parandalimin e situatave të konfliktit të interesit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.	KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY Pursuant to the Article 14 paragraph 1, subparagraph 1.2 of Law No.04/L-053 of the Kosovo Academy for Public Safety and Article 20 paragraph 3 of Law No. 06/L-011 on Prevention of Conflict of Interest in Discharge of Public Functions, Director General of the Kosovo Academy for Public Safety: Issues: REGULATION No----/2024 ON THE PREVENTION OF CONFLICT OF INTEREST IN THE KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY Article 1 Purpose The purpose of this Regulation is to define the criteria, rules and procedures related to the prevention of conflict of interest situations in the Kosovo Academy for Public Safety.	KOSOVSKA AKADEMIJA ZA JAVNU BEZBEDNOST U prilog članu 14 stav 1, podstav 1.2 Zakona br. 04/L-053 o Kosovskoj Akademiji za Javnu Bezbednost i članu 20 stav 3 Zakona br. 06/L-011 za Sprečavanje Sukoba Interesa u vršenju javnih funkcija, Generalni Direktor Kosovske Akademije za Javnu Bezbednost: Donosi: UREDBA BR----/2024 O SPREČAVANJU SUKOBA INTERESA U KOSOVSKOJ AKADEMIJI ZA JAVNU BEZBEDNOST Član 1 Cilj Cilj ove Uredbe je da definiše kriterijume, pravila i procedure u vezi sa sprečavanjem sukoba interesa u Kosovskoj Akademiji za Javnu Bezbednost.
---	---	--

Neni 2 Fushëveprimi Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të punësuarit në Akademinië e Kosovës për Siguri Publike. Neni 3 Përkufizimet 1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim: 1.1. AKSP - nënkupton Akademia e Kosovës për Siguri Publike; 1.2. I punësuar - nënkupton çdo të punësuar në AKSP; 1.3. Interes publik - nënkupton interesi material ose jo material i ligjshëm dhe i drejtë në dobi të qytetarëve; 1.4. Konflikt interesi - nënkupton një situatë apo rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare;	Article 2 Scope The provisions of this regulation apply to employees of the Kosovo Academy for Public Safety. Article 3 Definitions 1. The expressions and abbreviations used in this Regulation have the following meaning: 1.1. KAPS – means the Kosovo Academy for Public Safety; 1.2. Employee - means any employee in KAPS; 1.3. Public Interest - means legal and fair material or non-material interest for the benefit of citizens; 1.4. Conflict of Interest - means a situation or circumstance in which the official has a private interest, which affects, may affect or seems to affect the impartial and objective performance of his official duty;	Član 2 Polje delovanja Odredbе ove uredbе primenjuju se na zaposlene u Kosovskoj Akademiji za Javnu Bezbednost Član 3 Definicije 1. Izrazi i skraćenice koji se koriste u ovoj Uredbi imaju sledeće značenje: 1.1. KAJB – podrazumeva Kosovsku Akademiju za Javnu Bezbednost; 1.2. Zaposleni – podrazumeva svakog zaposlenog u KAJB; 1.3. Javni interes – podrazumeva zakonit i pravičan materijalni i nematerijalni interes u korist građana; 1.4. Sukob interesa – podrazumeva situaciju ili okolnost u kojoj službeno lice ima privatni interes koji utiče, može uticati ili izgleda da utiče na nepristrasno i objektivno vršenje njegove službene dužnosti;
--	--	--

1.5. Interes privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përfitim për personin zyrtar, familjen, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat zyrtari ka pasur apo ka marrëdhënie afariste; 1.6. Punë sekondare - nënkupton punën dhe angazhimin e të punësuarve që kryejnë jashtë AKSP-së, me apo pa pagesë; 1.7. Përfitim i padrejtë - nënkupton çdo pasuri dhe përfitim i padrejtë material dhe jo material; 1.8. Çdo emër i përdorur në gjininë mashkullore nënkupton edhe gjininë tjetër; 1.9. Shprehjet tjera të përdorura në këtë rregullorë kanë kuptimin ashtu siç përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe me aktet e tjera të brendshme të AKSP-së.	1.5. Private interest of the official person - means any benefit for the official person, family, relatives, friends and persons or organizations with which the official had or has business relations; 1.6. Secondary job - means the job and commitment of employees who perform outside KAPS, with or without payment; 1.7. Unfair benefit - means any material and non-material wealth and unfair benefit; 1.8. Any noun used in male gender also implies the other gender; 1.9. Other expressions used in this regulation have the meaning as defined by Law no. 04/L-053 for the Academy of Kosovo for Public Safety and with other internal acts of KAPS.	1.5. Privatni interes službenog lica – podrazumeva svaku korist za službeno lice, porodicu, rodbinu, prijatelje i lica ili organizacije sa kojima je službeno lice bilo ili ima poslovne odnose; 1.6. Sekundarni posao – podrazumeva rad i angazovanje zaposlenih koji obavljaju van KAJB, sa ili bez plaćanja; 1.7. Nepravedna korist – podrazumeva svaku materijalnu i nematerijalnu imovinu i nepravednu korist; 1.8. Bilo koje ime upotrebljena u muškom rodu podrazumeva i drugi rod; 1.9. Ostali izrazi koji se koriste u ovoj uredbi imaju značenje definisano Zконом br. 04/L-053 za Kosovsku Akademiju za Javnu bezbednost i sa drugim internim aktima KAJB-a.
--	---	---

Neni 4 Parimet e veprimt dhe mos veprimt të zyrtarit	Article 4 The principles of action and non-action of the official	Član 4 Principi postupanja i nepostupanja službenog lica
1. Parimet e veprimt dhe mos veprimt të zyrtarit të AKSP-së janë: 1.1. të ushtrojë funksionin e tij në pajtim me ligjin, aktet përkatëse dhe me Kodin e etikës në AKSP; 1.2. të kryejë punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit dhe institucionit dhe me punën e tij të forcojë besimin e qytetarëve në institucione; 1.3. gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vë para interesit publik; 1.4. zyrtari përgjigjet personalisht për veprimet e tij gjatë ushtrimit të funksionit në të cilin është emëruar apo caktuar; 1.5. zyrtarit nuk i lejohet të kryejë një veprim të kundërligjshëm apo të mos	1. The principles of action and non-action of the KAPS official are: 1.1. to discharge his function in accordance with the law, relevant acts and the Code of Ethics in the KAPS; 1.2. to perform his work with honesty, conscience, impartiality, to preserve the authority of the official and the institution and with his work to strengthen the trust of citizens in the institutions; 1.3. while discharging the public function, he/she shall act in defense of the public interest and has no right to put his private interest before the public interest; 1.4. the official is personally responsible for his actions during the exercise of the function in which he was appointed or assigned; 1.5. the official is not allowed to perform an illegal action or not to perform a legal	1 Principi postupanja i nepostupanja službenika KAJB su: 1.1. da obavlja svoju funkciju u skladu sa zakonom, relevantnim aktima i etičkim Kodeksom KAJB-a; 1.2. da svoj posao obavlja pošteno, savesno, nepristrasno, da čuva autoritet službenika i institucije i svojim radom jača poverenje građana u institucije; 1.3. u vršenju javne funkcije mora postupati u odbrani javnog interesa i nema pravo da svoj privatni interes stavlja ispred javnog interesa; 1.4. službenik je lično odgovoran za svoje postupke tokom vršenja funkcije na koju je imenovan ili raspoređen; 1.5. službeniku nije dozvoljeno da izvrši nezakonitu radnju ili da ne izvrši pravnu

kryejë një veprim të ligjshtëm, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, me qëllim të marrjes së një përfutimi të padrejtë për vete ose një personi apo subjekt tjetër; 1.6. zyrtari për punën që kryen në ushtrimin e funksionit nuk ka të drejtë të pranojë apo kërkojë shpërblym tjetër si dhe ofrimin ose premtimin e shpërblymit përveç kompensimit që i lejohet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi; 1.7. zyrtari duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje; 1.8. zyrtari nuk mund të përdorë pozicionin apo funksionin e vet për t'i avancuar interesat e veta personale apo të personave të afërëm. Neni 5 Veprimet e ndaluara për zyrtarin e AKSP-së 1. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të AKSP-së i ndalohen këto veprime: 1.1. të kërkojë apo pranojë dhuratë apo përfutim tjetër të padrejtë për vete apo	action, during the exercise of his function, in order to obtain an unfair benefit for himself or another person or entity; 1.6. for the work he performs in his function, the official has no right to accept or solicit any other reward, as well as the offer or promise of reward in addition to the compensation allowed based on the legal provisions in force; 1.7. the official shall avoid the conflict of interest regardless of whether it is real, potential or apparent; 1.8. the official cannot use his position or function to advance his personal interests or those of relatives. Article 5 KAPS Official's Forbidden Actions 1. During the discharge of the public function, the KAPS's officials are forbidden to take the following actions: 1.1. to solicit or receive a gift or other unfair benefit for himself or another	radnju, u toku vršenja svoje funkcije, radi prihvajanja nepravedne koristi za sebe ili drugo lice ili lice; 1.6. za posao koji obavlja u vršenju funkcije, službenik nema pravo da prihvati ili zahteva bilo koju drugu naknadu, kao ni ponudu ili obećanje naknade, osim naknade koja mu je dozvoljena na osnovu zakonskih odredbi na snazi; 1.7. službenik mora da izbegava sukob interesa bez obzira da li je stvaran, potencijalan ili prividan; 1.8. službenik ne može koristiti svoj položaj ili funkciju za unapređenje svojih ličnih interesa ili interesa srodnika. Član 5 Zabranjena postupanja za službenika KAJB-a 1. Za vreme vršenja javne funkcije, službeniku KAJB zabranjene su sledeće radnje: 1.1. da zatraži ili prihvati poklon ili drugu nepravednu korist za sebe ili drugo lice, ili
---	---	---

personin tjetër, ose ofertë apo premtim për dhuratë, në mënyrë që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë në kryerjen e detyrës së tij zyrtare; 1.2. të kërkojë, përvetësojë, pranojë shpërblime, dhurata, përfitime apo shërbitime të padrejta për vete ose për tjetrin si kompensim për përcaktimin e tij në vendimmarrje; 1.3. të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimt të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik; 1.4. të premtojë, ofrojë ose japë dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër të padrejtë në këmbim të ndonjë dhurate apo përfitimi të padrejtë real ose të premtuar; 1.5. të ndikojë në kontraktimin, dhënien e punëve apo furnizimeve publike për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik; 1.6. të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;	person, or an offer or promise of a gift, so that the official acts or does not act in the discharge of his official duty; 1.2. to solicit, appropriate, accept valuables or rewards for himself or other persons as a compensation for his/her vote during decision making process; 1.3. To influence the decision of any official or any public entity for personal benefit or for the benefit of any other natural or legal person. 1.4. to promise, offer or give a gift or any other unfair benefit in exchange for any actual or promised gift or unfair benefit; 1.5. to influence on contracting, awarding public works or public supplies for unfair personal benefits or any other natural or legal person; 1.6. to use confidential information that he has at his/her possession or information obtained in good faith during the discharge of public functions for unfair personal benefits or for any other natural or legal persons;	ponudu ili obećanje poklona, tako da službeno lice postupa ili ne postupa u vršenju službene dužnosti; 1.2. da zahteva, prisvaja, prihvata nepravedne nagrade, poklone, beneficije, ili usluge za sebe ili za druge kao nadoknadu za svoju odlučnost u donošenju odluka; 1.3. da utiče na odluku bilo kog službenika ili organa iz razloga nepravedne koristi za sebe ili bilo koje drugo fizičko ili pravno lice; 1.4. obećati, ponuditi ili dati poklon ili bilo koju drugu nepravednu korist u zamenu za bilo kakav stvarni ili obećani poklon ili nepravednu korist; 1.5. da utiče na ugovaranje, dodelu radova ili javnih nabavki za nepravedne koristi za sebe ili bilo koje drugo fizičko ili pravno lice; 1.6. da koristi pouzdane informacije kojima raspolaže ili ih je primio u dobroj veri u vršenju svoje funkcije za nepravednu korist za sebe ili bilo koje drugo fizičko ili pravno lice;
--	---	---

1.7. të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik; 1.8. të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik; 1.9. të ndërmarrë veprime me efekte ndëshkuese apo të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme të zyrtarëve apo subjekteve që ofrojnë informata për raste të konfliktit të interesit të zyrtarit, personave të lidhur me të ose personave të besuar për këtë shkak. 1.10. të përdorë ose të lejojë që të përdoren pasuritë zyrtare të institucionit punëdhënës, përfshirë dokumentet zyrtare, për ndonjë qëllim tjetër që nuk përputhet me ushtrimin e detyrës publike.	1.7. to undertake actions which in any way shall suit to his personal interest or to the any other natural or legal person; 1.8. to undertake actions which in any way shall suit or shall be in favor of private interest of another person but are damaging to the public interest; 1.9. to undertake actions with punitive effects or become an obstacle to obtaining the legal rights of officials or entities that provide information on cases of conflict of interest of the official, persons related to him or persons trusted for this reason. 1.10. to use or allow to be used the official assets of the employing institution, including official documents, for any other purpose that is inconsistent with the discharge of public duty.	1.7. da preduzima radnje koje će na bilo koji način odgovarati njegovom ili ličnom interesu nekog drugog fizičkog ili pravnog lica; 1.8. preduzima radnje koje bi na bilo koji način odgovarale ili favorizovali privatni interes drugog lica na štetu javnog interesa; 1.9. da preduzme radnje sa kaznenim dejstvom ili postane prepreka za ostvarivanje zakonskih prava službenika ili subjekata koji daju informacije o slučajevima sukoba interesa službenika, sa njim povezanih lica ili lica od poverenja iz tog razloga. 1.10. da koristi ili dozvoli da se koristi službena imovina institucije koja zapošljava, uključujući službena dokumenta, za bilo koju drugu svrhu koja nije u skladu sa vršenjem javnih dužnosti.
---	---	---

Neni 6 Aktivitetet e lejuara për zyrtarin e AKSP-së	Article 6 Allowed activities for the KAPS official	Član 6 Dozvoljene aktivnosti za službenika KAJB-a Službenik KAJB-a može da se bavi sekundarnim poslovima u oblastima kao što su: nauka, sport, nastava, obuka, seminari, jednostavan rad, istraživanje, kultura i humanitarne aktivnosti. Ove aktivnosti može obavljati službenik KAJB-a, ako nema sukoba interesa ili ako aktivnost nije zabranjena drugim zakonskim odredbama.
Zyrtari i AKSP-së mund të angazhohet në punë sekondare në lëmitë, si: shkencë, sport, mësimdhënie, trajnime, seminare, punë të thjeshta, hulumtime, kulturë dhe veprimtari humanitare. Këto aktivite mund të ushtrohen nga zyrtari i AKSP-së, nëse nuk ka konflikt të interesit apo nëse aktiviteti nuk është i ndaluar me dispozita të tjera ligjore.	The KAPS official can be engaged in secondary work in fields such as: science, sports, teaching, training, seminars, simple work, research, culture and humanitarian activities. These activities may be exercised by the KAPS official, if there is no conflict of interest or if the activity is not prohibited by other legal provisions.	
Neni 7 Angazhimi në punë sekondare 1. Zyrtari i AKSP-së, përveq punës në AKSP mund të angazhohet edhe në ndonjë punë tjetër sekondare.	Article 7 Engagement in secondary work 1. KAPS official, in addition to working in KAPS, can be also engaged in any other secondary work.	Član 7 Angažovanje u sekundarnim poslovima 1. Službenik KAJB-a, pored rada u KAJB-u, može da se bavi i bilo kojim drugim sekundarnim poslom.
2. Secili zyrtar i AKSP-së, i cili dëshiron të angazhohet në punë sekondare, paraprakisht duhet të bëjë kërkesë me shkrim, duke plotësuar aplikacionin për punë sekondare (Aplikacioni i hartuar nga AKSP - shtojca nr. 1 në këtë Rregullore të brendshme).	2. Each KAPS official who wishes to engage in secondary work must first make a written request, by completing the application for secondary work (Application drafted by KAPS - Appendix No. 1 to these Internal Regulations).	2. Svaki službenik KAJB-a, koji želi da se angažuje na sekundarnom poslu, mora prvo da podnese zahtev u pisanoj formi, popunivši aplikaciju za sekundarni posao (Aplikacija sastavljena od strane KAJB-a - prilozi br. 1 u ovoj unutrašnjoj uredbi).
3. Aplikacioni duhet të jetë i plotësuar me komentimin e mbikqyrësit të drejtëpërdrejtë brenda dy (2) ditë pune nga data e pranimit të kërkesës për punë sekondare.	3. The application must be completed with the comment of the direct supervisor within two (2) working days from the date of receipt of the request for secondary work.	3. Aplikacija se mora popuniti sa komentarom direktnog nadležnog u roku od dva (2) radna dana od dana prihvatanja zahteva za sekundarni posao.

4. Aplikacioni i plotësuar dhe i kompletuar duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore në formë fizike apo elektronike (përmes aplikacionit përkatës), para se të fillohet puna sekondare. 5. Divizioni i burimeve njerëzore brenda shtatë (7) ditë pune nga data e pranimin të kërkesës për punë sekondare, shqyrton dhe vendos për kërkesën e aplikuesit. 6. Të emëruarit veprimet në përputhje me ligjin në fuqi dhe nuk bëjnë kërkesë për punën sekondare. 7. Në rastet kur zyrtari caktohet nga AKSP për të zhvilluar një punë sekondare, nuk është i obliguar të marrë leje nga Divizioni për burime njerëzore. 8. Kërkesa për punë sekondare duhet të bëhet edhe për angazhim në institucione publike. 9. Aprovimi për angazhim në punë sekondare mund të bëhet edhe drejtpërdrejtë nga drejtori i përgjithshëm i AKSP-së për ndonjë kërkesë specifike. 10. Lidhur me vendimin e Divizionit për burime njerëzore pala e pakënaqur ka të	4. The fulfilled and completed application must be submitted to the Human Resources Division in physical or electronic form (through the relevant application), before starting the secondary work. 5. The Human Resources Division, within seven (7) working days from the date of receipt of the request for secondary work, reviews and decides on the applicant's request. 6. The appointees act in accordance with the law in force and do not request secondary work. 7. In cases where the official is assigned by KAPS to perform a secondary work, he is not obliged to obtain permission from the Human Resources Division. 8. The request for secondary work must also be made for engagement in public institutions. 9. Approval for engagement in secondary work can also be made directly by the Director General of KAPS for any specific request. 10. Regarding the decision of the Human Resources Division, the dissatisfied party has	4. Popunjena i kompletirana aplikacija mora se predati Diviziji za ljudske resurse u fizičkom ili elektronskom obliku (preko odgovarajuće aplikacije), pre početka sekundarnog posla. 5. Divizija za ljudske resurse, u roku od sedam (7) radnih dana od dana prijema zahteva za sekundarni posao, razmatra i odlučuje o zahtevu podnosioca aplikacije. 6. Imenovani postupaju u skladu sa zakonom na snazi i ne podnose zahtev za sekundarni posao. 7. U slučajevima kada je službenik određen od strane KAJB-a da razvija jedan sekundarni posao, on nije obavezan da dobije dozvolu od strane Divizije za ljudske resurse. 8. Zahtev za sekundarni posao mora se podneti i za angažovanje u javnim institucijama. 9. Odborenje za angažovanje na sekundarnim poslovima može se dati i direktno od strane generalnog direktora KAJB-a za neki specifičan zahtev. 10. U vezi sa odlukom Divizije za ljudske resurse, nezadovoljna stranka ima pravo žalbe u
--	---	---

drejtë ankese sipas legjislacionit në fuqi.	the right to appeal according to the legislation in force.	skladu sa zakonima na snazi.
Neni 8 Detyrimi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit 1. Me marrjen e detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private. 2. Në rast se zyrtari ka dyshime apo konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë, ai duhet të këshillohet dhe të informojë sa më parë udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo udhëheqësin e mesëm apo të lartë. Gjatë kësaj kohe, zyrtari duhet të pezullojë të gjitha veprimet që ndërlikohen me këtë qëshije, deri në vendimin përkatës në lidhje me rastin. 3. Çdo udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit. 4. Në rast se udhëheqësi apo institucioi nuk	Article 8 Obligation to prevent and resolve conflict of interest 1. Upon taking the duty and during its discharge, the official has the duty to prevent and resolve by himself in the most effective way possible, any situation of conflict between his public and private interests. 2. In case the official has doubts or finds that a conflict of interest has arisen or may arise, he should consult and inform the direct manager or middle or senior manager as soon as possible. During this time, the official must suspend all actions related to this matter, until the relevant decision regarding the case. 3. Each leader shall take all necessary measures to prevent and solve conflict of interest cases. 4. In case the leader or the institution is not	Član 8 Obraveza sprečavanja i rešavanja sukoba interesa 1. Po stupanju na dužnost i tokom njenog vršenja, službenik je dužan da na najefikasniji mogući način spreči i sam reši svaku situaciju sukoba između njegovih javnih i privatnih interesa. 2. U slučaju da službenik sumnja ili utvrdi da je došlo do sukoba interesa ili da može nastati, on mora biti obavešten i obavestiti direktnog rukovodioca ili srednjeg ili višeg menadžera što je pre moguće. Za to vreme službeno lice mora da obustavi sve radnje u vezi sa ovom materijom, do donošenja relevantne odluke u vezi sa predmetom. 3. Svaki lider mora preduzeti sve neophodne mere da spreči i reši slučajeve sukoba interesa. 4. U slučaju da rukovodilac ili institucija nije

është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit apo dyshon se edhe vetë ka ose mund të ketë konflikt të interesit, atëherë i drejtohet Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vendosje lidhur me rastin e dyshuar. 5. Zyrtari apo institucioni i ndërmerr veprimet e nevojshme brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.	convinced about the existence of the conflict of interest or suspects that he himself has or may have a conflict of interest, then he shall address to the Agency for the Prevention of Corruption for a decision regarding the suspected case. 5. The official or the institution undertakes the necessary actions within the period of thirty (30) days.	uveren u postojanje sukoba interesa ili sumnja da i sam ima ili može da ima sukob interesa, obraća se Agenciji za sprečavanje korupcije za odluku u vezi sa sumnjivi slučaj. 5. Službenik ili institucija preduzima potrebne radnje u roku od trideset (30) dana.
Neni 9 Tentimi dhe ndikimi në vullnetin e zyrtarit 1. Nëse ekziston tentimi i ndikimit në vullnetin e tij, zyrtari duhet ta lajmëtojë me shkrim dhe të konsultohet me udhëheqësin e tij te drejtëpërdrejtë apo me udhëheqësin më të lartë që e ka zgjedhur apo emëruar në mënyrë që të shmang çdo ndikim në vullnetin e tij. 2. Nëse ndaj zyrtarit gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtëpërdrejtë apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime për të vepruar apo mos vepruar, zyrtari e njofton	Article 9 Attempting and influencing the will of the official 1. If there is an attempt to influence his will, the official shall notify in writing and consult with his direct supervisor or with the senior leader who has chosen or appointed him in order to avoid any influence on his will. 2. If to the official, direct or indirect influence is exercised during and in connection with the discharge of the public function, openly or anonymously to act or not to act, the official notifies in writing the institution that has	Član 9 Pokušaj i uticaj na volju službenika 1. Ako postoji pokušaj uticaja na njegovu volju, službeno lice mora d aga pismeno obavesti i konsultuje se sa svojim neposrednim prepostavljenim ili najvišim rukovodiocem koji ga je izabrao ili imenovaokako bi izbegao bilo kakav uticaj na njegovu volju. 2. Ako se vrši direktan ili indirektan uticaj na službenika tokom i u vezi sa vršenjem javne funkcije, otvoreno ili anonimno da postupa ili ne postupa, službenik pismeno obaveštava instituciju koja ga je izabrala ili imenovala kao i

me shkrim institucionin që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit e cila pas shqyrtimit do të vendosë nëse ekziston një bazë e arsyeshme që të lajmërohen organet e ndjekjes.	chosen or appointed him as well as the Agency for the Prevention of Corruption which after review will decide whether there is a reasonable basis to notify the prosecuting authorities.	Agencija za sprečavanje korupcije koja će nakon razmatranja odlučiti da li postoji razuman osnov da obavesti organe gonjenja.
